

# Platforma për të Drejtat e Njeriut

## Goal: SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE

Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

### Target: 3.1

Deri në vitin 2030, të zvogëlohet raporti global i vdekshmërisë së nënave në më pak se 70 vdekje për 100,000 lindje.

#### Instrumentet ndërkombëtare

#### Nenet

Neni 12

#### KEFDG

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

1. Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushën e kujdesit për shëndetin për t'u siguruar, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, mundësitë për të përfutur shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit të familjes. 2. Megjithatë dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, shtetet palë u sigurojnë grave gjatë barrës, lindjes dhe pas lindjes, shërbime të përshtatshme, po qe nevoja, falas, si dhe ushqim të përshtatshëm gjatë barrës dhe mbajtjes së fëmijës në gjë.

Neni 12.2

#### KEFDG

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas

**12.2** Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit I të këtij neni, Shtetet Palë do t'u sigurojnë grave shërbime të përshtatshme në lidhje me shtatzaninë, lindjen dhe periudhën pas lindjes, duke u dhënë shërbime falas, aty ku është e nevojshme, si dhe ushqim adekuat gjatë shtatzanisë dhe laktacionit.

#### PNDCP

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Neni 6.1

Cdo qenie njerëzore ka të drejtën e natyrshme të jetës. Kjo e drejtë mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga jeta e tij.

#### DUDNJ

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Neni 3

Gjithkush ka të drejtën për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit.

**Instrumentet  
ndërkombëtare**

**Nenet**

Neni 25 para 1

DUDNJ

Deklarata Universale për  
të Drejtat e Njeriut

1. Gjithkush ka të drejtë për një nivel jetese të mjaftueshëm i cili t'i përgjigjet shëndetit dhe jetës së përshtatshme si të atij personalisht, ashtu edhe të familjes së tij, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banesën, kujdesin mjekësor dhe shërbimet e nevojshme sociale, si edhe të drejtën për të qenë i siguar në rast sëmundjeje, papunësie, vejanie, pleqërie dhe raste të tjera të humbjeve të mjeteve për jetesë për shkak të rrethanave të pavarura nga vullneti i tij.

**Ligjet**

**Nenet**

Nuk ka rezultat